



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
SEKRETARIATI TEKNIK I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

RAPORT MONITORIMI PËR ZBATIMIN E PROCESIT BUXHETOR

Periudha e Raportimit Janar- Prill 2017

Në zbatim të nenit 65 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 1, datë 15.1.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, ushtron aktivitetin buxhetor në programin buxhetor “Shërbime të tjera”.

Në përdorimin e fondeve buxhetore jemi mbështetur në parimet e menaxhimit dhe funksionimit të sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat e STKKU-së, duke pasur si synim përdorimin eficient të këtyre burimeve sipas programimit të bërë për vitin 2017.

I. Fondet buxhetore të ndryshuara për vitin 2017 për STKKU-në në total janë 43 767 mijë lekë prej të cilave 32,100 mijë lekë janë shpenzime korente dhe 15 667 mijë lekë për shpenzime kapitale. Këto fonde sipas zërave të strukturës buxhetore paraqiten sipas tabelave të mëposhtme, ku jepen edhe realizimet përkatëse për secilin prej tyre për 4 mujorin e vitit 2017.

KESHILLI KOMBËTAR I UJIT
SEKRETARIATI TEKNIK I KESHILLIT KOMBËTAR TË UJIT


Pasqyra Nr.1

SHPENZIMET KORENTE JANAR - PRILL 2017

Entiteti Qeverisjes	Ministria e Linjes	Kodi I Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi Thesarit	Buxheti vjetor 2017 I rishikuar	Shpenzimet Faktike Janar-Prill 2017	Diferenca	
										% realizimit
1	2	3	4	5	6	7	8	12	13	
001	87	1087016	01	01150	6000000	3535	23,100	6,928	16,172	30
001	87	1087016	01	01150	6010000	3535	4,000	1,106	2,894	28
001	87	1087016	01	01150	6020000	3535	5,000	529	4,471	11
TOTALI							32,100	8,564	23,694	27

Një paraqitje grafike e realizimit të treguesve sipas artikujve jepet në pasqyrë:

Grafiku 1 Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve



Referuar Tabelës nr. 1, realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente për 4 mujorin e parë të vitit 2017 është në masën 27 %, në raport me totalin e vitit 2017, dhe 107% në raport me periudhën 4 mujore, kjo si rezultat i rritjes së pagave në muajin Mars të këtij viti.

Më poshtë analizojmë faktorët që kanë ndikuar në këtë realizim:

- **Mosrealizimi vërehet kryesisht në zërin Shpenzime Operative** ku buxheti vjetor është 5,000 mijë, janë realizuar 529 mijë lekë ose në masën 11%. Ky realizim i ulët vjen si pasojë e faktit të kufizimeve për përdorimin e fondeve për trajnime, dieta dhe konferenca të cilat zënë një masë të konsiderueshme të buxhetit të vënë në dispozicion për vitin 2017, pasi një pjesë e personelit ka përfituar trajnime apo pjesëmarrje në aktivitete të cilat janë financuar nga donatorët.
- **Fondi i pagave dhe Sigurimeve shoqerore** (zërat 600 dhe 601) janë realizuar për periudhën 4 mujore për art. 600 dhe art. 601, respektivisht nga 30% dhe 28% e buxhetit vjetor, dhe respektivisht 107% dhe 110% e periudhës 4 mujore. Kjo për faktin se në zbatim të VKM nr. 187, datë 08.03.2017 u aplikua rritja e pagave për punonjesit.

Tabela 2. Shpenzime Kapitale

KESHILLI KOMBETAR I UJIT
SEKRETARIATI TEKNIK I KESHILLIT KOMBETAR TE UJIT

Formati nr.10 : FORMULARI I MONITORIMIT TE INVESTIMEVE


Per 4 Mujorin e vitit 2017

Ne mijë lekë

	<i>Emertimi i Projektit</i>	<i>Kodi i Projektit</i>	<i>Buxheti I Rishtikuar 2017</i>	<i>Fakti</i>	<i>Realizimi ne %</i>	<i>Komente (Problematika)</i>
	TOTALI		15,667	116	1%	
1	Studim fizibiliteti per percaktimin e fushave te kerkimit shkencor per burimet ujore dhe menaxhimin e risqeve	M870057	14,167	-	0%	
	Pajisje elektronike	M870018	700	-	0%	-
2	Akses kontroll	M870103	120	116	97%	Realizuar 100%
3	Pajisje te tjera zyre	M870023	680	-	0%	-

Më poshtë paraqitet grafikisht realizimi i investimeve për 4 mujorin e parë 2017

Grafiku 2 Realizimi i investimeve për 4 Mujorin I viti 2017



Referuar Tabelës nr. 2 realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale për 4 mujorin e vitit 2017, është në masën 1% e fondit total, ndërsa si projekte realizimi është në masën 100% .

Projekti me kod M 870057 “Studim fizibiliteti për përcaktimin e fushave të kerkimit shkencor për burimet ujore dhe menaxhimin e risqeve” nuk është realizuar, pasi është në procedurë prokurimi, realizimi i së cilës është parashikuar të përfundojë deri në fund të vitit 2017.

Projekti me kod M 870018 “Paisje elektronike”, nuk është realizuar, parashikohet të përfundojë gjatë 4 mujorit të dytë të vitit 2017.

Projekti me kod M 870103 “Akses Kontroll”, është realizuar 100%.

Projekti me kod M870023 “Paisje të tjera zyre” nuk është realizuar.

II. Objektivat për vitin 2017

1. Ndërtimi i një sistemi total të integruar për drejtimin dhe menaxhimin efektiv të burimeve ujore;
2. Ndërtimi i një sistemi të integruar të informacionit në fushën e ujit
3. Mirëmanaxhimi kombëtar i burimeve ujore
4. Mirëadministrimi dhe mbrojtja e ujrave ndërkufitare
5. Optimizimi i vendimtarëve të KKU-së për përdorimin e burimeve ujore
6. Mirëfunksionimi i Këshillave të Baseneve Ujore, Përcaktimi i zonave të ruajtjes bazuar në Ligjin 111/2012
7. Njohja e plotë e institucioneve qendrore me problematiken e dhënies së autorizimeve për veprimtarinë ndërtimore në brigje.
8. Ndërtimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të burimeve njerezore, financiare dhe aseteve si pjese e sistemit total të integruar të qeverisjes dhe manxhimit të burimeve ujore.

Realizimi i objektiveve nënkupton realizimin e aktiviteteve dhe produkteve, të pasqyruara në PBA për vitin buxhetor 2017.

Në funksion të realizimit të objektiveve janë kryer aktivitetet dhe realizuar produktet si më poshtë vijon:

Në mënyrë grafike realizimi i produkteve paraqitet:

Grafiku 3 Realizimi sipas produkteve



Produkti A: Hartimi dhe Miratimi i Programit Kombëtar Sektorial dhe hartimi i planit të veprimit për zbatimin e tij

Është realizuar 80% e dokumentit. Është përfunduar drafti i PKS i cili është konsultuar në nivelin e nëngrupeve tematike. Ky dokument do të konsultohet më tej me pushtetin vendor dhe donatorët përpara se të ndjekë procesin e miratimit me VKM.

Produkti B: Implementimi i Programi Kombëtar Sektorial nëpërmjet zbatimit të planeve të veprimit të detajuara për sektorin. Realizimi i produkti është në masën 20%.

Ka filluar hartimi i planit të veprimit 2018-2020, ku nga ana e STKKU është përgatitur struktura dhe pjesa përshkuese e dokumentit. Të gjitha këto janë prezantuar dhe referuar në nëngrupet tematike. Pritet që në mbledhjet e ardhëshme ky dokument të finalizohet.

Produkti C: Ndjekja e mbledhjeve të Nëngrupeve Tematike

Është realizuar në masën 40%, Jane organizuar 9 mbledhje me nëngrupet tematike për të diskutuar mbi finalizimin e PKS-së dhe hartimin planit të veprimit 2018-2020.

Produkti D: Organizimi i mbledhjeve të Grupit për Menaxhimin e Integruar të Politikave për Ujin (GMIP), është realizuar në masën 50%.

Më datë 22.2.2017 është organizuar mbledhje e KKU-së ku është prezantuar drafti i PKS-së. Duke qënë se PKS është ende në proces konsultimesh nuk është bërë mbledhje e GMIP ku pjesëmarrës janë edhe donatorët. Megjithatë me datë 15.3.2017 në Ambasadën Gjermane përpara të gjithë donatorëve është prezantuar drafti i PKS. Mbledhje e GMIP do të bëhet kur dokumenti të jetë në fazë miratimi.

Produkti E: Ndjekja e Kadastrës kombëtare të burimeve ujore dhe hartimi i inventarit të burimeve ujore është realizuar rreth 100%. Ky projekt është dorëzuar nga konsulenti në MBZHRAU, por popullimi më të dhëna dhe instalimi i softëve nuk ka përfunduar ende. Nga STKKU është marrë pjesë në wrokshopin e organuzar për Kadastrën ku janë dhënë edhe komentet përkatëse. Gjithashtu në kuadër të këtij projekti është organizuar edhe një takim me MBZHRAU ku është diskutuar mbi komentet e STKKU për përgatitjen e draft VKM per Funksonimin dhe mirëmbajtjen e Kadastrës Kombetare të Burimeve Ujore.

Produkti F: Hartimin dhe monitorimi i standardeve, rregullave dhe përputhshmërinë e informacionit në bashkëpunim me ASIG dhe institucionet e tjera qëndrore dhe vendore, është realizuar në masën 100%. Është bërë takim me përfaqësues të ASIG për të përshtatur standartin dhe për të ndjekur procesin e miratimit të Kadastrës Kombëtare te Burimeve Ujore nga Bordi i Informacionit Gjeohapësinor (BIG).

Produkti G: Ndjekja, miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore. Për realizimin e këtij produkti është punuar në rreth 40 % e tij në raport me planin vjetor. Takime për përmirësimin e variantit përfundimtar të shpërndarë për mendim dhe komente nëpër institucione.

Produkti H: Ndjekja e procesit të hartimit, miratimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit të Baseneve Drin-Bunë dhe Seman

Është realizuar rreth 45% e produktit. Janë bërë takime për plotësimin e draftit paraprak të dorëzuar nga konsulenti si dhe për ecurinë e procesit konform afateve të kontratës.

Produkti M: Ndjekja e mardhënieve me vendet fqinje për administrimin e ujërave ndërkufitare. Është realizuar në masën 10% e totalit. Pjesmarrje në mbledhjet e KPAUN, projektet e DCG si pjesë e komitetit drejtues dhe grupeve të punës, workshop-eve të ndryshme me këtë fokus. Jemi akoma në pritje të informacionit nga institucionet respektive të dokumentacionit ligjor që disponojnë në lidhje me mardheniet ndërkufitare.

Produkti N: Organizimi i mbledhjeve të KKU dhe zbatimi i detyrave të lëna nga ky organ Është realizuar 1 mbledhje të KKU nga 6 të mbledhjeve të planizuara për vitin 2017. Është në proces përgatitje të materialit përfundimtar për mbledhjen e radhës sipas axhendës së përcaktuar.

Produkti O: Kontrolli i veprimtarisë të organeve vendore të Menaxhimit të Burimeve Ujore. Realizimi i këtij produkti është në proces, nga 6 kontrole janë realizuar 2. Një takim dhe dy mbledhje KBU-je për basenin Drin-Bunë, dy takime dhe dy mbledhje KBU-je për Basenin Mat, një takim për Basenin Ishëm-Erzen, dy mbledhje KBU-je Baseni Shkumbin dhe një mbledhje Baseni Seman.

Produkti P: Përcaktimi i zonave të ruajtjes referuar Ligjit 111/2012

Nuk është realizuar, është në proces, korespondence me AKZM për hartimin e planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura si pjesë përbërëse e planeve të menaxhimit, takim me konsulentin që po harton planet e menaxhimit Drin-Bunë dhe Seman për njohjen me problematiken.

Produkti Q: VKKU për shpalljen e trupave të caktuar ujore si artificialë dhe tepër të modifikuar. Janë realizuar 3 takime nga 5 takime të planizuara dhe workshop i organizuar nga GIZ për njohjen me situatën.

Produkti R: VKKU për veprimtari ndërtimore në brigje

Është realizuar 1 takim nga 3 të planifikuara, pra rreth 30 % e produktit.

Mbahet korespondencë me MBZHRAU në vazhdimësi për problematiken, takim me AKPT për harmonizimin e planeve të detajuara vendore me planet e menaxhimit.

Produkti S: Modelemi, implementimi dhe monitorimi i sistemit të integruar të menaxhimit të burimeve financiare, është realizuar rreth 30%. Janë kryer takimet e radhës me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera. Është siguruar informacion nga donatorët që kanë investuar në fushën e ujit dhe përgatitja e drafteve të buxhetimit të integruar të sektorit.

Produkti SH: Modelemi, implementimi dhe monitorimi i sistemit të integruar të menaxhimit të burimeve njerëzore është realizuar rreth 30% e produktit. Janë organizuar takime me institucione që lidhen drejtpërdrejtë me burimet njerëzore të sektorit të ujit, si trajnime nga DAP dhe nga organizata të tjera.

Produkti T: Blerja e paisjeve për mbarëvajtjen e punës dhe realizimin e objektivave në STKKU. Relazimi i këtij produkti është në masën 8% e totalit. Është realizuar blerja e zërit -

Sistem karte aksesi, për hyrjen në institucion, ndërsa zëri pajisjet elektronike, dhe pajisje të ndryshme zyresh janë planifikuar për 4 mujorin II të këtij viti.

Produkti U: **Projekte në ndihme të institucioneve që merren me menaxhimin e ujit, (Studim Fizibiliteti).** Eshtë në fazën përgatitore të procedurës së prokurimit, për studim fizibiliteti për përcaktimin e fushave të kërkimit shkencor për burimet ujore dhe menaxhimin e risqeve të tyre.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI KOMBËTAR I UJIT

HANTIN BONATI

